


# TIPOLOGJI E TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE NË SHQIPËRI



# **TIPOLOGJI E TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE NË SHQIPËRI**

## Tipologji e trafikimit të fëmijëve në Shqipëri

Botuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Prezenca në Shqipëri

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2020

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Materiali që përmban ky botim mund të citohet ose rishtypet me kusht që të njihet autorësia e tij dhe një kopje e botimit që përmban materialin e rishtypur t'i dërgohet OSBE-së. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por që nuk kufizohet në përdorimin komercial apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky botim, kërkon lejen me shkrim të OSBE-së.

Autorët: Aidan Mcquade

Juliana Rexha

Anila Trimi

**ISBN: 123456789**

Përmbajtja e botimit është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

# Përmbajtja

Falënderime.....	5
Përmbledhje.....	7
Shkurtime.....	9
Fjalorth.....	10
1.0 Hyrje.....	13
1.1 Disa përkufizime.....	13
2.0 Metodologjia.....	16
3.0 Vështrim i përgjithshëm mbi kampionin e përzgjedhur.....	17
3.1 Gjinia.....	17
3.2 Moshë.....	17
3.3 Gjeografia.....	18
3.4 Frekuentimi i shkollës.....	19
3.5 Përdorimi i alkoolit dhe substancave.....	20
4.0 Aspekte të trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve në Shqipëri.....	21
4.1 Vajzat dhe shfrytëzimi seksual.....	21
4.2 Lypja dhe përfshirja në aktivitete kriminale.....	23
4.3 Abuzime të tjera.....	25
5.0 Rekrutimi dhe kontrolli .....	26
5.1 Shfrytëzimi i vulnerabilitetit personal: gjinia.....	26
5.2 Shfrytëzimi i vulnerabilitetit që lidhet me situatën: varësia ndaj substancave narkotike dhe alkoolit.....	27
5.3 Shfrytëzimi i vulnerabilitetit rrethor: varfëria.....	29
6.0 Zbatimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit.....	30
7.0 Përpjekjet për mbrojtjen e fëmijës.....	33
7.1 Mbrojtja e menjëhershme.....	33
7.2 Masat e mbrojtjes.....	36
8.0 Përfundime dhe Rekomandime.....	38



# Falënderime

Ky studim u kushtohet fëmijëve që përshkruhen në të, të cilët meritojnë ta jetojnë jetën me dinjitet e përkujdesje dhe që mbështeten edhe në përpjekjet tona të përbashkëta për t'ua siguruar këtë gjë.

Dëshirojmë që ky studim të kontribuojë për përmirësimin e një sistemi të brishtë, por në rritje të qëndrueshme, të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, në mënyrë që ai të jetë në gjendje të parandalojë të gjitha llojet e abuzimit të të drejtave të fëmijëve dhe të mbrojë fëmijët në rrezik dhe viktimat e trafikimit dhe shfrytëzimit.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë Dr. Aidan McQuade, i cili përgatiti strukturën e studimit dhe të bazës së të dhënave dhe rishikoi rrënjësisht studimin. Ekspertiza e tij unike dhe analiza e thellë ishin përcaktuese në përgatitjen e këtij studimi dhe mundësuan skeletin mbi të cilin punuan autorët: zj. Juliana Rexha, Oficere Kombëtare e Antitrafikimit në Prezencën e OSBE-së në

Shqipëri dhe zj. Anila Trimi, eksperte e pavarur e kontraktuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë edhe zj. Jonita Kabashi, Koordinatore në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, e cila ka mbledhur dhe përshkruar të gjitha rastet, si edhe ka ruajtur kontakte të vazhdueshme me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve që kanë dhënë rastet.

Ky studim nuk do të ishte realizuar pa kontributin e vlefshëm të Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve në bashkitë Tiranë, Shkodër, Korçë, Bulqizë, Durrës, Elbasan, Kukës, Kamëz, Krujë, Kavajë, Lezhë, të cilët punojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijës, që është sa në ndryshim aq edhe kompleks, me qëllimin që të ofrojnë mbrojtje për fëmijët në nevojë.



# Përmbledhje

Ky studim mbështetet në shqyrtimin e 45 rasteve të viktimave të mundshme të trafikimit të fëmijëve - 31 vajza dhe 14 djem.

Të dhënat u mblodhën nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës gjatë periudhës 2016-2019. Periudha e përzgjedhur përkon me punën e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për të mbështetur institucionet shqiptare në trajtimin e rasteve të trafikimit të fëmijëve bazuar në sistemin e mbrojtjes së fëmijës.

Nga 45 rastet e shqyrtuara, 39 ishin identifikuar nga autoritetet si viktimat të mundshme të trafikimit të fëmijëve. Këto raste sugjerojnë se trafikimi për shfrytëzim seksual, në veçanti nëpërmjet punës në klubet e natës dhe në industrinë e argëtimit në Shqipëri, është një rrezik parësor për trafikimin e vajzave, ndërsa trafikimi për qëllime të lypjes së detyruar dhe veprimtari kriminale është një rrezik parësor për trafikimin e djemve. Ndonëse në këtë trafikim shpesh përfshihen edhe palë të treta, janë identifikuar disa raste ku trafikimi lehtësohet apo tolerohet nga vetë prindërit e fëmijës.

Pjesa më e madhe e rasteve të shqyrtuara në këtë studim, 41 nga 45, nuk përfshinin elementin ndërkombëtar në to. Për më tepër, ato përfaqësonin rreziqe të trafikimit apo shfrytëzimit të fëmijës tërësisht brenda kufijve të Shqipërisë. Kjo vë në dukje nevojën për reformimin e kuadrit ligjor në Shqipëri me qëllim njohjen e trafikimit si një dukuri që ndodh sa brenda vendit edhe në kontekstin ndërkombëtar.

Studimi gjen edhe të dhëna domethënëse të bashkërendimit ndërmjet strukturave shtetërore për mbrojtjen e fëmijës në reagimin fillestar të rasteve të identikuara: në 41 nga 45 rastet u diskutuan në grupet teknike ndërsektoriale.

Megjithatë, studimi gjen edhe probleme domethënëse në lidhje me menaxhimin e rasteve. Për shembull, nga 39 raste të identikuara si fëmijëve viktimat të mundshme të trafikimit, vetëm një prej tyre u identifikua formalisht dhe në mënyrë përfundimtare si trafikimi i fëmijëve. Më tej, në 11 raste shfrytëzimi vijoi edhe pas identifikimit të fëmijës si viktimë e mundshme e trafikimit. Nga këto 11 raste, tetë ishin raste të vajzave që shfrytëzoheshin seksualisht, pra, u lanë në duart e trafikuesve pavarësisht nga rreziqet e identikuara. Këto dështime kaq flagrante mund të jenë rrjedhojë e një anshmërie gjinore sistemike, një çështje që kërkon hulumtim të mëtejshëm dhe, nëse është e nevojshme, edhe zgjidhje urgjente.

Me fjalë të tjera, ky studim ka gjetur mungesë të një vendimmarrjeje të shprehur në lidhje me identifikimin e trafikimit, mungesë të ndjekjes në vazhdimësi të hetimit penal, dhe mangësi shqetësuese në dhënien e masave të duhura të mbrojtjes. Gjithashtu, studimi gjeti një standard të dobët të mbajtjes së të dhënave.

Ndaj, këto gjetje tregojnë se sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri ka ende mjaft nevojë që të forcohet, sidomos në lidhje me bashkërendimin e punës dhe ndjekjen në vazhdimësi të rasteve.

Studimi rekomandon forcim më të madh të sistemit të mbrojtjes së fëmijës nëpërmjet shtimit të trajnimit për strukturat kryesore, përfshirë ato të zbatimit të ligjit, punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe shkollat. Gjithashtu, duhen përmirësuar dhe bashkërenduar sistemet për mbledhjen dhe studimin e të dhënave, si edhe duhet një bashkërendim më i efektshëm midis strukturave për mbrojtjen e fëmijës, me qëllim



sigurimin e ndjekjes në vazhdim të hetimeve dhe të një mbrojtjeje efikase të fëmijës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe politikat përkatëse. Së fundi, nevojitet të ofrohet më shumë

përkujdesje e specializuar për fëmijët që janë traumatizuar si pasojë e trafikimit, përfshirë shërbimet e specializuara që të trajtojnë varësinë e krijuar te fëmijët.

## SHKURTIME

<b>NJMF</b>	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
<b>PMF</b>	Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës
<b>MKR</b>	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
<b>ZKKA</b>	Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Antitrafikimin
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>ODIHR</b>	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
<b>ASHDMF</b>	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
<b>PSV</b>	Procedura Standarde të Veprimit

# FJALORTH

Përkufizimi	Kuptimi
Dhunë ndaj fëmijës	Çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.
Fëmijë	Çdo person nën moshën 18 vjeç. Shiko ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
Fëmijë i pashoqëruar	Fëmija që është ndarë nga të dy prindërit ose të afërmit e tjerë të familjes dhe për të cilin nuk kujdeset ndonjë person madhor. <i>Shiko ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”</i>
Fëmijë në nevojë për mbrojtje	Personi nën moshën 18 vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individi nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin. <i>Shiko ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.</i>
Identifikim dhe reagim fillestar	Tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë dhe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si të institucioneve vendore, ashtu edhe qendrore që bën të mundur përcaktimin se një person i/e mitur apo i/e rritur është viktimë e mundshme e trafikimit të personave. Mjetet e identifikimit fillestar janë treguesit dhe intervista: në rast se në sjelljen dhe paraqitjen e personit ka elementë që janë të përfshirë në listën e treguesve, atëherë personi kalohet në intervistë fillestare. <i>Shiko “Procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 29.8.2018.</i>
Identifikimi Formal	Identifikimi i një personi si viktimë trafikimi i kryer vetëm nga Grupi/Struktura Përgjegjëse për Identifikim Formal (G/SPIF) në bazë të formatit të intervistës formale. Në rastin e fëmijëve, (G/SPIF) përbëhet nga një punonjës i policisë së shtetit i seksionit të luftës kundër trafikëve të paligjshme dhe PMF/NJMF. <i>Shiko “Procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 29.8.2018.</i>
Interesi më i lartë i fëmijës	E drejta e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. <i>Shiko ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.</i>
Mbrojtje e fëmijës	Parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës. <i>Shiko ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; Neni 3 “Përkufizime”.</i>

Menaxhimi i rastit	Metodologjia që siguron, hap pas hapi, ofrimin në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive të ndihmës për fëmijën në nevojë për mbrojtje dhe që synon të promovojë e të nxisë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e tij. <i>Shiko: “Procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, Vendim i Këshilli të Ministrave Nr. 578, datë 3.10.2018.</i>
Plan individual i mbrojtjes	Plani me veprime të caktuara, me qëllim mbrojtjen e fëmijës dhe parandalimin e cenimit të integritetit të tij, garantimin e të drejtave, mirëqenies, shëndetit dhe zhvillimit të tij, duke mbështetur familjen e fëmijës në realizimin e këtij plani, kur kjo është në interesin me të lartë të fëmijës. <i>Shiko: “Procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes” Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 578, datë 3.10.2018.</i>
Procedurat Standarde të Veprimit	<i>Procedura të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 29.8.2018, që parashikojnë veprimet sektoriale dhe ndërsektoriale për identifikimin, referimin dhe ndihmën ndaj viktimave të mundshme dhe viktimave të trafikimit në Shqipëri, përfshirë fëmijët dhe të rriturit.</i>
Sistemi i integruar i mbrojtjes të fëmijës	Tërësia e akteve ligjore, politike dhe e shërbimeve të nevojshme, në të gjitha fushat, veçanërisht në ato të mirëqenies sociale, edukimit, shëndetit, sigurisë dhe drejtësisë, me qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve që shfaqen gjatë zbatimit të tyre. Institucionet përgjegjëse marrin masa konkrete, me qëllim bashkëpunimin, ndarjen e përgjegjësisë dhe bashkërendimin ndërmjet të gjitha agjencive qeveritare, organeve të vetëqeverisjes vendore, ofruesit e shërbimeve publike ose jopublike, grupeve të komunitetit, përfshirë sistemin e referimit të rasteve, si elemente përbërëse të sistemit të mbrojtjes së fëmijës. <i>Shiko ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.</i>
Tregues të trafikimit	Elementë përshkrues të procesit të trafikimit që reflektojnë paraqitjen e efekteve/pasojave të trafikimit te personat me shtetësi shqiptare ose të huaj. Treguesit janë të ndarë në dy kategori: për fëmijë dhe për të rritur. <i>Shiko “Procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 29.8.2018.</i>
Viktimë e mundshme trafikimi	Është personi ndaj të cilit ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi mund të jetë trafikuar, por nuk është kryer ende identifikimi formal nga autoritetet. <i>Shiko “Procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 29.8.2018.</i>
Viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore	Çdo person fizik, që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, siç përcaktohet në nenin 3 të Protokollit “Protokolli mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”, që plotëson Konventën e Kombeve të bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

Vlerësimi	<p>Proces që përfshin vlerësimin fillestar dhe vlerësimin e plotë. Kryhet nga PMF-ja/NJMF-ja. Vlerësimi fillestar është një vlerësim i shpejtë i nivelit të rrezikut, nevojave bazë të fëmijës dhe shërbimeve të domosdoshme. Kryhet mundësisht brenda 24 orëve dhe maksimalisht, brenda 48 orëve pas raportimit të rastit. Vlerësimi i plotë kryhet për çdo rast të fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe ka si qëllim të përcaktojë në mënyrë të plotë nivelin e rrezikut, në të cilin ndodhet fëmija, si dhe të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes. <i>Shiko: “Procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes” Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 578, datë 3.10.2018.</i></p>
-----------	--

# 1.0 Hyrje

Shfrytëzimi seksual dhe për punë mund të çojë në pasoja të rënda që mund të zgjasin gjithë jetën si për zhvillimin fizik edhe atë psikologjik. Prandaj, shtetet kanë për detyrë të garantojnë dhe nxisin mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe të garantojnë mbrojtje të mjaftueshme për fëmijët viktimë të trafikimit. Për më tepër, fëmijët viktimë të trafikimit dhe shfrytëzimit kanë nevojë të posaçme dhe paraqesin sfida shtesë për profesionistët e mbrojtjes së fëmijëve dhe agjencitë ligjzbatuese.

Shqipëria ka ngritur një kuadër kombëtar ligjor dhe institucional bazuar në parimin e “interetit më të lartë të fëmijës” për parandalimin, mbrojtjen, hetimin, dhe ndjekjen penale të trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve. Së bashku me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Identifikimin, Referimin dhe Asistencën e Viktimave të Trafikimit, të përditësuara, ekziston një bazë e qëndrueshme ligjore që nxit bashkëpunimin ndërsektorial për të luftuar të gjitha format e trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve.

Ky studim paraqet gjetjet nga të dhënat e mbledhura gjatë mbështetjes nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezenca në Shqipëri, për institucionet qendrore dhe vendore përgjegjëse për adresimin e trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve në Shqipëri. Kjo mbështetje u dha në kontekstin e gjerë të sistemit kombëtar të mbrojtjes së fëmijës. Studimi synon të japë një vështrim në brendësi të trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve në Shqipëri, bazuar mbi raste konkrete, si dhe të rekomandojë zgjidhje me karakter ligjor dhe praktik për realizimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Studimi synon të kuptojë më mirë se si funksionon sistemi i mbrojtjes së fëmijës në Shqipëri në lidhje me rastet e fëmijëve të identifikuar si viktimë të mundshme dhe viktimë të trafikimit. Ai mbështetet në të dhëna të hollësishme nga 45 raste të menaxhuara nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës në njëmbëdhjetë bashki. Rastet janë për zgjedhur ndër ato të mbledhura nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në kuadrin e mbështetjes nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, si raste me tregues të fortë të trafikimit të fëmijëve.

## 1.1 Disa përkufizime

Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, sipas legjislacionit shqiptar fëmijë konsiderohet personi nën 18 vjeç. Moshë minimale për punë është 16 vjeç, përveçse gjatë periudhës së pushimeve kur fëmijët mbi 15 vjeç mund të punësohen në punë të lehta.

Sipas konventave ndërkombëtare, të ratifikuara nga Shqipëria, punë e papranueshme e fëmijës është puna e rëndë e fëmijës, puna që e pengon të shijojë fëmijërinë, të shfrytëzojë potencialin e vet dhe të jetojë me dinjitet. I referohet punës që është e dëmshme për zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës dhe pengon shkollimin duke e privuar nga mundësia për të frekuentuar shkollën; apo e detyron të braktisë shkollën; apo të ndjekë shkollën ndërkohë që kryen punë të rëndë dhe në orare të zgjatura.

**Trafikimi i fëmijëve është** “*rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja*”e

një fëmijë me qëllim shfrytëzimin. Për qëllim të përkufizimit, nuk ka rëndësi nëse trafikimi ndodh jashtë ose brenda kufijve të vendit. Në dallim nga trafikimi i personave të rritur, nuk ka rëndësi të provohen “mjetet” e përdorura për të vendosur një fëmijë në situatë shfrytëzimi. Fëmijët nuk mund të japin pëlqimin e tyre për t’u shfrytëzuar.

“Protokolli i Palermos” për “Parandalimin, luftën dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, sidomos grave dhe fëmijëve” e përkufizon shfrytëzimin si, *“minimalisht, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, punës apo shërbimeve të detyruara, skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve”*<sup>1</sup>. Pra, trafikimi i fëmijëve lidhet me një sërë formash abuzimi të cilat janë më specifike dhe më të rënda se rastet më të përhapura të punës së papranueshme të fëmijës.

Trafikimi i fëmijës mund të ndodhë dhe në kontekstin familjar nëse niveli i shfrytëzimit përputhet me përshkrimin e trafikimit të fëmijës sipas përkufizimit të Protokollit të Palermos.

Neni 3 i Konventës 182 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës përkufizon ndër format më të rënda të punës së fëmijës:

(a) Të gjitha format e skllavërisë apo praktikave të ngjashme me të, sic janë shitja dhe trafikimi i fëmijëve, lidhja nga borxhi dhe puna e detyruar dhe e sforcuar, përfshirë këtu rekrutimin me forcë apo të detyruar të fëmijëve për përdorim në konfliktet e armatosura;

(b) Përdorimin, prokurimin dhe ofrimin e fëmijës për prostitucion, për prodhime pornografike apo për shfaqje pornografike;

(c) Përdorimin, prokurimin dhe ofrimin e fëmijës për aktivitete të jashtëligjshme, në mënyrë të vecantë për prodhimin dhe trafikimin e drogave sipas përkufizimeve që i bëhen atyre në traktatet përkatëse ndërkombëtare;

(d) Për punë, të cilat nga natyra dhe kushtet që kryhen, përmbajnë rrezikun e dëmeve për shëndetin, sigurinë dhe moralin e fëmijëve.

Përkufizimi i Organizatës Ndërkombëtare të Punës konkurrin me përkufizimin e shfrytëzimit sipas Protokollit të “Palermos”. Megjithatë, ky përkufizim shton në mënyrë të shprehur “aktivitetet e paligjshme” si formë e rëndë e punës së fëmijës. Rrjedhimisht, për arsye të përdorimit të një termi gjithëpërfshirës, në këtë studim do të përdoret përdorimi i fëmijëve në aktivitete të paligjshme si një kategori shtesë e shfrytëzimit që qëndron në përputhje me standardin e përkufizimit të trafikimit të fëmijëve.

<sup>1</sup> Protokolli “Për “Parandalimin, luftën dhe ndëshkimin e trafikimit të personave sidomos, grave dhe fëmijëve” - <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/protocoltraffickinginpersons.aspx> - vizituar më 12 gusht 2019.

Figura 1 përmbledh përkufizimet kryesore:




Figura 1: Punë e lejuar e fëmijëve, punë e papranueshme e fëmijëve, trafikimi i fëmijëve



## 2.0 Metodologjia

Studimi mbështetet në të dhëna të mbledhura nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës (PMF) gjatë periudhës 2016 - 2019 për fëmijët e klasifikuar si viktime të mundshme apo të identifikuara të trafikimit sipas përkufizimit të përcaktuar në Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) në Shqipëri. Periudha e përzgjedhur përkon me punën e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për të mbështetur institucionet shqiptare në trajtimin e trafikimit të fëmijëve nëpërmjet një kuadri për mbrojtjen e fëmijës.

Gjatë kësaj periudhe, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka dhënë ekspertizë teknike dhe mbështetje për një koordinator të dedikuar enkas në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF). ASHDMF-ja mbikëqyri punën e PMF-ve dhe mbledhi të dhëna që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës, në kuadrin e përgjegjësisë ligjore të ASHDMF-së.

Të dhënat e marra nga PMF-të u ndanë më pas me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik (ZKKA), e cila verifikoi statusin e hetimit për secilin rast nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Policisë.

Për këtë studim, u shqyrtuan të dhëna që kishin të bënin në total me 45 fëmijë. Nga këta, 31 ishin

vajza dhe 14 djem.

Për të gjitha rastet në fjalë, ne u përpoqëm të mbledhim informacione të hollësishme për profilin e fëmijëve, bazuar në kontekstin e tyre personal dhe të familjes; faktorët shtytës dhe tërheqës të tillë si niveli i arsimimit, kushtet social-ekonomike dhe faktorë të tjerë vulnerabiliteti, gjinia dhe moshë. Në bazë të studimeve të Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijës (PMF), ky studim analizon llojet e shfrytëzimit të fëmijëve të hasura në secilin rast, duke përdorur kuadrin ligjor ndërkombëtar lidhur me punën e fëmijëve, përfshirë trajtën më të keqe të tij, dhe trafikimin e fëmijëve.

Ky studim merr në shqyrtim rolin dhe funksionimin e strukturave si dhe të procedurave aktuale për mbrojtjen e fëmijës në Shqipëri, në veçanti në lidhje me punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, policinë, shërbimet sociale shtetërore dhe ato që ofrohen nga OJQ-të, si dhe shkollat. Shteti shqiptar u ka besuar këtyre individëve dhe agjencive sigurimin e asistencës së menjëhershme dhe afatgjatë për fëmijë viktime potenciale dhe të identifikuara të trafikimit. Ky studim, shqyrton faktin se sa i përmbushin ato standardet dhe pritshmëritë e përcaktuara në legjislacionin dhe politikën përkatëse në Shqipëri.

# 3.0

## Vështrim i përgjithshëm mbi kampionin e përzgjedhur

### 3.1 Gjinia

Siç u vu në dukje më lart, nga 45 rastet e analizuara, 31 ose 68.8% ishin vajza dhe 14 ose 31,1% ishin djem.




Figura 2: Ndarja gjinore në studim.

Rastet tregojnë një ndarje të qartë gjinore. Vajzat janë dukshëm në rrezik për shfrytëzim seksual, ndërsa për djemtë rreziku parësor është lypja e detyruar dhe kriminaliteti.

Rreth 70 % e vajzave në rastet e shqyrtuara në këtë studim shfaqin tregues të rrezikut për shfrytëzim seksual nga të rriturit. Rreth gjysma e rasteve të djemve në rastet e shqyrtuara në këtë studim shfaqën tregues shfrytëzimi për lypje, ku një e treta e rasteve meshkuj ishin të përfshirë edhe në veprimtari kriminale të tilla si vjedhja dhe shpërndarja e drogës. Në rastet e shqyrtuara, nuk ka pasur tregues për shfrytëzimin seksual të djemve.



#### RAST STUDIMI

“A” është një djalë 14 vjeç i identifikuar vazhdimisht në situatë rruge të cilin policia e kapi duke vjedhur. Ai i tregoi një punonjësi të mbrojtjes së fëmijës se e kishte detyruar një person i rritur i cili e përdorte dhe për të shpërndarë lëndë narkotike. PMF-ja e ndoqi rastin nga afër. “A” nuk është më në situatë rruge dhe tani vijon të ndjekë shkollën. Për familjen është siguruar ushqim dhe ndihmë ekonomike. Nëna e tij u referua për punësim.

### 3.2 Moshë

Nga rastet e analizuara, moshë e vajzave në kohën e identifikimit ishte nga 12 në 17 vjeç. Pjesa më e madhe, 29 nga 31 gjithsej ose 93% e tyre ishin të moshës 14-16 vjeç. Djemtë e identifikuar në këtë studim ishin të moshës 11 deri në 16 vjeç, ku 6 nga 14 prej tyre (43%) identifikuan moshë midis 14 dhe 16 vjeç. Në një rast, një foshnjë nën një vjeç, nëna e të cilit vuante nga shëndeti mendor,

u identifikua nga Policia e Kufirit ndërkohë që “persona të panjohur” po tentonin ta dërgonin foshnjën në Greqi për birësim të paligjshëm.

Me fjalë të tjera, këto raste sugjerojnë se ata që janë më në rrezik trafikimi në Shqipëri janë fëmijët adoleshentë për të cilët kontrolli prindëror mungon dhe ofrimi i shërbimeve nga strukturat shtetërore bëhet më i vështirë.




Figura 3: Ndarja sipas moshës në studim

### 3.3 Gjeografia

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të rasteve të marra në shqyrtim, i përkasin bashkive Tiranë, Shkodër, Korçë, Bulqizë, Durrës, Elbasan, Kukës, Kamëz, Krujë, Kavajë, Lezhë. Tirana ka numrin më të lartë si të djemve edhe të vajzave, me 51% të rasteve të identifikuar. Duhet theksuar që në bashkinë Tiranë janë të angazhuara njëmbëdhjetë skuadra terreni për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge, duke ndikuar kështu në rritjen e numrit të identifikimit të rasteve nëpërmjet planifikimit të punës në terren dhe masave proaktive nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës dhe policisë.

Bashkitë e mbështetura nga Prezenca e OSBE-së<sup>2</sup> përbëjnë pjesën më të madhe të rasteve në shkallë vendi në bazë të të dhënave të Studimit të Fëmijëve në Situatë Rruge<sup>3</sup> 2015 dhe studimit vjetor të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Antitrafik në Shqipëri.

Nga 45 rastet, 11 fëmijë u identifikuan jashtë territorit të bashkisë së origjinës së tyre. Vetëm katër prej rasteve përfshinin aspekte ndërkombëtare ku të paktën një pjesë e shfrytëzimit të fëmijës kishte ndodhur jashtë territorit të Shqipërisë.

Kjo është një pikë e rëndësishme që institucionet shqiptare duhet ta marrin parasysh. Pavarësisht të dhënave të qarta nga ky studim se një pjesë domethënëse e trafikimit në lidhje me Shqipërinë është tërësisht brenda vendit, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë<sup>4</sup> vijon ta përkufizojë trafikimin e fëmijëve si një formë e krimit ndërkombëtar. Trafikimi brenda vendit duhet të njihet në mënyrë të shprehur në Kodin Penal.

Sa u takon rasteve që përfshijnë aspekte ndërkombëtare: njëri prej tyre kishte të bënte me një vajzë nga Kosova<sup>5</sup> e cila u trafikua për shfrytëzim seksual në Shqipëri por u identifikua nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit e Korçës. Një rast tjetër kishte të bënte me një vajzë që në moshën 14 vjeçe u trafikua në Maqedoninë e Veriut për martesë të detyruar. Një rast i tretë kishte të bënte me një djalë të trafikuar për birësim të paligjshëm. Rasti i katërt kishte të bënte me një djalë që ishte trafikuar në Maqedoninë e Veriut për lypje të detyruar duke sugjeruar kështu se bashkërendimi në nivel rajonal mbetet një faktor i rëndësishëm në luftën kundër trafikimit.

4 Neni 128/b, "Trafikimi i të miturve".

5 Çdo referencë për Kosovën në këtë tekst, përsa i përket territorit, institucioneve dhe popullatës, duhet kuptuar sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara 1244.

### Bashkitë ku janë identifikuar rastet




Figura 4: Rastet sipas bashkive

## 3.4 Frekuentimi i shkollës

Nga të dhënat e mbledhura, 67.7% e vajzave të identifikuara dhe 78.5% e djemve e kanë braktisur arsimin bazë të detyruar.

Roli i shkollave në studimin e braktisjes së shkollës nga fëmijët njihet gjerësisht si një paralajmërim i hershëm i efektshëm dhe një instrument për

parandalimin e trafikimit të fëmijëve. Që prej miratimit të ligjit “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, shkollat janë të detyruara raportojnë pranë Njësive të Mbrojtjes së Fëmijës dhe të bashkërendohen me to në lidhje me fëmijët që janë në rrezik të braktisjes së shkollës apo që e kanë braktisur atë tashmë.




Figura 5: Frekuentimi i shkollës



## RAST STUDIMI

*Z. dhe E. janë vëllezër përkatësisht 12 dhe 14 vjeç nga Shkodra. Prindërit e tyre janë ndarë dhe fëmijët kanë ndërruar disa shkolla për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme që vijnë nga jetesa me njërin prind apo me tjetrin. Duke marrë parasysh se gjatë qëndrimit me babanë ata jetonin në situatë rruge për pjesën më të madhe të kohës, gjykata ia dha nënës të drejtën ligjore të kujdestarisë. Megjithatë, të dy fëmijët kanë jetuar në situatë rruge në Tiranë për të paktën tre vjet. Ata janë shfrytëzuar për lypje dhe në veprimtari të ndryshme kriminale. Që të dy janë përdorues substancash.*

### 3.5 Përdorimi i alkoolit dhe substancave

Përveç faktit se përdorimi i alkoolit dhe narkotikëve është i dëmshëm për shëndetin e fëmijëve, ai paraqet edhe rreziqe shtesë për ata vetë, familjen dhe komunitetin. Studime të ndryshme tregojnë se përdorimi i alkoolit apo i drogave të ndryshme nga adoleshentët ka një diapazon faktorësh rreziku që mund të sjellin pasojë që çënojnë arsimimin e tyre, në mënyrë të dukshme kriminale, shtatzëni të padëshirueshme dhe depresion. Në studim, 19.3% e vajzave dhe 42.0% e djemve u identifikuan si përdorues

të substancave apo të alkoolit. Kjo e rrit vulnerabilitetin e tyre dhe i ndihmon shfrytëzuesit e tyre t'i mbajnë nën kontroll.

Trajtimi i nevojave specifike të këtyre fëmijëve që janë në të njëjtën kohë edhe përdorues të alkoolit, narkotikëve dhe/ose që paraqesin çështje të shëndetit mendor, është aktualisht një sfidë e skajshme për sistemin, për shkak të mungesës së shërbimeve të specializuara për këtë grup të synuar.

## 4.0

# Aspekte të trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve në Shqipëri

## 4.1 Vajzat dhe shfrytëzimi seksual

### *Klubet e natës*

Tetëmbëdhjetë (18) raste të shqyrtuara përfshinin vajza që punonin në klube nate. Gjashtë prej tyre, që të gjitha nën moshën 16 vjeç, ishin të përfshira edhe në ndonjë formë të aktiviteteve seksuale. Të gjitha, përveç njëres nga këto të gjashta, ishin njohur si viktima të mundshme trafikimi - dhe shqyrtimi i rasteve sugjeron se që të gjashta ishin

në të vërtetë viktima potenciale të trafikimit. Megjithatë, nuk është aspak e qartë nga të dhënat ekzistuese nëse është regjistruar hetim penal në lidhje me trafikimin në këto raste, dhe as nëse ka pasur ndonjë hetim për bizneset ku punonin këto vajza dhe ku mund të kishte ndodhur edhe shfrytëzimi.



### RAST STUDIMI

*F. është një vajzë 16 vjeçare nga Tirana, por u identifikua si viktimë e mundshme e trafikimit në Shkodër në vitin 2016 dhe u referua pranë një Punonjëseje për Mbrojtjen e Fëmijës në Tiranë. Ajo ishte larguar nga shtëpia dhe kishte qëndruar në një apartament me qira në Tiranë bashkë me shoqe të tjera. Gjatë intervistës me Punonjësen e Mbrojtjes së Fëmijës, ajo shfaqti tregues se ishte shfrytëzuar seksualisht ndërsa punonte si kamariere në një klub nate. Në kohën e identifikimit, ajo u shpreh se i ati e kishte abuzuar seksualisht. Para se të shkonte në apartamentin me qira, ajo kishte qëndruar larg familjes për pjesën më të madhe të kohës, në shoqërinë e grupeve apo individëve të dyshuar si të përfshirë në veprimtari të paligjshme. Ajo është më e madhja e pesë fëmijëve, njëri prej të cilëve nuk jetonte më. Familja jetonte në kushte të varfërisë ekstreme, duke u mbështetur tek ndihma nga shërbimet sociale. Pas identifikimit si viktimë e mundshme e trafikimit, F. u transferua në një strehëz për viktimat e trafikimit, që drejtohej nga një OJF, jashtë Tiranës. Që prej referimit të saj, Punonjësja e Mbrojtjes së Fëmijës nuk ka pasur asnjë informacion në lidhje me hetimin e trafikantëve.*

Të kuptoje llojin e punës që vajzat e reja bënin në klubet e natës ishte një detyrë sfiduese për shkak të “situatave të fshehta të punës” në të cilën ishin të përfshira. Rastet e studiuara nga PMF-të tregojnë se puna e vajzave përfshinte këndimin, kërcimin dhe shërbimin si kameriere. Megjithatë, disa e shprehën qartë në intervistë se ato i kishin shfrytëzuar seksualisht.

**e papranueshme për fëmijët** që të “punojnë në kushte veçanërisht të vështira të tilla si puna me orë të gjata apo gjatë natës.” Ligji shqiptar nuk lejon për asnjë rrethanë punën gjatë natës për personat nën moshën 18 vjeç. Ky studim konfirmon atë që institucionet vendore kanë dyshuar prej kohësh: që puna në klubet e natës është veçanërisht me rrezik për vajzat dhe mund të çojë në trafikimin e tyre për t’u shfrytëzuar seksualisht.




Figura 6: Jetesa në shtëpi

RAST STUDIMI

*E., një vajzë 15 vjeçare, supozohet të jetojë me të ëmën në Tiranë, po duket të jetë krejtësisht jashtë kontrollit prindëror. Ajo largohet nga shtëpia në mënyrë të përsëritur dhe qëndron me meshkuj në moshë madhore që dyshohet se e trafikojnë. Në 2018, ajo u klasifikua si viktimë e mundshme e trafikimit. Rasti është ndjekur nga afër nga një punonjës i mbrojtjes së fëmijës nëpërmjet vizitave në familje, referime në OJF të specializuara për trajtim psikologjik dhe ofrimin e strehës, çka ajo ka refuzuar ta pranojë. Nuk ka ende një hetim të plotë të rastit.*

Legjislacioni shqiptar<sup>6</sup>, në përputhje me Rekomandimin 190 (1999) të Konventës Nr. 182 të ILO-së njeh se duhet konsideruar si **punë**

<sup>6</sup> Në mars 2019, Këshilli i Ministrave, me mbështetjen teknike të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, miratoi një vendim për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, duke krijuar procedurat për identifikimin dhe referimin e rasteve të punës së fëmijëve nga Inspektorati i Punës të Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve. Për të forcuar zbatimin e tij, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri i dha Inspektoratit Shtetëror të Punës një metodologji për inspektorët e punës për mënyrën e monitorimit të punës së fëmijëve dhe koordinimin me institucionet e duhura, si policia dhe punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, në rastet kur ata dyshonin të kishte punë të fëmijëve. Gjithashtu, Prezenca mbështeti hartimin e një Plan-Veprimi Kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, të cilin Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale e nënshkroi në tetor 2019.

### Të jetuarit larg shtëpisë

Kur vajzat largohen nga shtëpia apo qëndrojnë larg shtëpisë për një periudhë të gjatë është një tregues i mirënjohur për shfrytëzimin seksual të tyre që mund të çojë edhe në trafikim.<sup>7</sup> Ne gjetëm 16 (nga 31 vajza gjithsej) raste të studiuara të vajzave që ishin larguar ose e braktisnin shpesh shtëpinë, 8 nga të cilat ishin klasifikuar si viktime të mundshme të trafikimit.

<sup>7</sup> Ky tregues është ndër treguesit e trafikimit të fëmijëve të përfshirë në Procedurat Standarde të Veprimit në Shqipëri për Viktimat e Mundshme dhe Viktimat e Trafikimit.

# Përmbledhje

Në rastet e dyshimit për shfrytëzim seksual, ato vajza që janë klasifikuar si viktime të mundshme të trafikimit u identifikuan nga një grup i përbashkët i policisë dhe punonjësve të mbrojtjes së fëmijës. Megjithatë, PMF-të janë shprehur se janë në dijeni vetëm të një rasti për regjistrim të hetimit ndaj trafikantëve të mundshëm.

Shqipëria ka hartuar legjislacion të përparuar

për punën, i cili e ndalon punën e fëmijëve. Megjithatë, kërkohen përpjekje më të forta për të parandaluar format më të këqija të punës së fëmijëve, në veçanti në lidhje me punën gjatë natës, si në rastet e përmendura më lart, ndërkohë që edhe zbulohen dhe ndiqen penalisht ata që përdorin, ofrojnë ose sigurojnë fëmijë për qëllime prostitucioni.




Figura 7: Përmbledhje e shqyrtimit të rasteve të vajzave

## 4.2 Lypja dhe përfshirja në aktivitete kriminale

Në një Studim të vitit 2014, EUROPOL përshkruan trafikimin e fëmijëve për qëllime të veprimtarisë kriminale: *“Trafikimi i fëmijëve për shfrytëzim me detyrim në veprimtari kriminale dhe lypje” thekson se Fëmijët janë një prej grupeve më vulnerabil, të shënjestruar për trafikim të qenieve njerëzore (TQNJ). Grupe të krimit të organizuar (GKO) zgjedhin të trafikojnë fëmijë sepse ata mund të rekrutohen lehtësisht dhe mund të zëvendësohen shpejt. Gjithashtu, GKO-të mund t’i mbajnë viktimat fëmijë relativisht me pak shpenzime dhe të veçuar. Shfrytëzimi i fëmijëve shkel të drejtat e fëmijës; për të pasur një fëmijëri të sigurt në kontekstin e tyre familjar, për të marrë arsim, për të pasur kohë për të luajtur, dhe për të qenë të mbrojtur nga shfrytëzimi”<sup>8</sup>.*

8 Europol (2014) Intelligence Notification, Child trafficking for exploitation in forced criminal activities and forced begging. [https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/antitrafficking/files/child\\_trafficking\\_for\\_exploitation\\_in\\_forced\\_criminal\\_activities.pdf](https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/antitrafficking/files/child_trafficking_for_exploitation_in_forced_criminal_activities.pdf)

Ne gjetëm 13 raste të fëmijëve të përfshirë në lypje - 12 djem dhe një vajzë. Të gjithë ishin duke jetuar ende me familjet e tyre dhe të gjithë e kishin braktisur shkollën. Një tjetër djalë, i përfshirë kryesisht në shpërndarjen e drogës, gjendej po ashtu në këtë model jetese: jetonte me familjen dhe e kishte braktisur shkollën.

Tetë prej këtyre 14 fëmijëve ishin shfrytëzuar gjithashtu nga palë të treta dhe i kishin përdorur në veprimtari kriminale si vjedhja dhe shpërndarja e drogës. Fëmijët që punojnë në rrugë, për lypje apo për veprime kriminale, priren të punojnë me orë të gjata dhe natën, ndërkohë që ekspozohen ndaj rreziqeve fizike dhe psikologjike dhe ndaj abuzimit.





## RAST STUDIMI

R. 16 vjec banon në Tiranë. Vajza është braktisur nga prindërit e saj dhe jeton me gjyshen ndaj të cilës ushtron dhunë në mënyrë të vazhdueshme. Gjatë intervistimit ajo pohon se është shfrytëzuar nga persona të tretë me qëllim prostitucioni dhe ka kryer mbi 60 vjedhje në dyqane. R qëndron për rreth një vit në Qendrën Pritëse të Trafikimit dhe më pas për dy muaj në një strehëz tjetër. Vajza është kthyer pranë gjyshes së saj ku është mbështetur me këshillim psikologjik, paketa ushqimore dhe referim për rregjistrim në shkollë. Vajza ka refuzuar bashkëpunimin dhe shërbimet. Nga informacionet e Punonjësës së Mbrojtjes së Fëmijës rasti vijon të jetë në situatë shfrytëzimi.

Ato raste kur nuk ka qenë e përfshirë një palë e tretë, ku lypja nxitej dhe kontrollohej brenda kontekstit të familjes, kjo sigurisht përbën formën më të keqe të punës së fëmijës, pasi ajo paraqet “punë e cila, për nga natyra apo rrethanat në të cilat kryhet, ka gjasë të dëmtojë shëndetin, sigurinë dhe moralin e fëmijëve.”

Studimi tregon se në shumicën e rasteve të lypjes, fëmijët ishin detyruar apo nxitur nga prindërit apo nga kujdestari ligjor. Këto raste mundet fare mirë të kategorizohen si punë e detyruar<sup>9</sup> si “punë apo shërbim që realizohet... nën kërcënimin e ndonjë ndëshkimi” dhe ato përfaqësojnë “përdorimin,

sigurimin, ose ofrimin e një fëmije për veprimtari të paligjshme”. Prandaj, edhe këto raste përbëjnë trafikim të fëmijëve.

Për këtë arsye, tetë rastet e kriminalitetit të detyruar të identifikuar në këtë studim ku fëmijët përfshihen në shpërndarjen e drogës përfaqësojnë në mënyrë pothuajse të sigurt trafikim të fëmijëve. Pesë prej këtyre fëmijëve u identifikuan gjithashtu si përdorues të substancave narkotike apo alkoolit, duke paraqitur sfida shtesë për mbrojtjen dhe riintegrimin e tyre si rrjedhojë e mungesës së shërbimeve të përshtatura për këta fëmijë.



Figura 8: Përmbledhje e rasteve që përfshijnë lypjen dhe krimet e vogla

<sup>9</sup> ILO, Konventa Nr. 29 për Punën e Detyruar (1930).



## RAST STUDI MI

*L. është një djalë 12 vjeçar, i cili lyp në Tiranë. Prindërit e tij janë të papunë në Tiranë, në kushte shumë të vështira social-ekonomike. Fëmija deklaroi se babai është i dhunshëm dhe se shpesh ai e rreh. Në kohën e identifikimit në situatë rruge, në vitin 2018, ai u gjet në gjendje intoksikimi. Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës u shpreh se ai qëndron në shoqërinë e një mashkulli në moshë madhore, i njohur si trafikues i disa djemve të rinj për qëllime lypjeje. Gjatë një interviste të përbashkët nga policia, shërbimi social shtetëror dhe njësisia e mbrojtjes së fëmijës, L bëhej shumë agresiv sa herë i përmendej familja, duke shfaqur nivele të larta të stresit emocional. Në mënyrë të përsëritur ai kërkonte që familja të mos njoftohej sepse i frikësohej abuzimit fizik që mund të pësonte më pas. Ai nuk donte të kthehej pranë familjes së tij. Autoritetet e klasifikuan si viktimë të mundshme të trafikimit dhe ai u referua për asistencë në shtëpinë e fëmijës në Tiranë. Rasti u referua në Prokurori.*

### 4.3 Abuzime të tjera

Siç u vu në dukje edhe më lart, në një rast, një foshnjë nën një vjeç, nëna e të cilit vuante nga çrregullime të shëndetit mendor, u identifikua nga Policia e Kufirit ndërkohë që “persona të panjohur” po tentonin ta dërgonin foshnjën në Greqi për birësim të paligjshëm. Foshnja iu rikthye nënës, pavarësisht nga paaftësia e saj për t’u kujdesur për foshnjën dhe iu dha mbështetje për plotësimin e nevojave bazë dhe ndihmë ligjore falas për disa muaj deri sa nëna u largua nga qyteti.

Ndonëse është pozitive të theksohet mekanizmi i efektshëm i referimit si dhe reagimi nga shumë struktura, ku rasti u vlerësua nga një grup ndërsektorial, ky rast ngre gjithashtu shqetësime në lidhje me përshtatshmërinë e shërbimeve të dhëna duke marrë parasysh se nëna nuk ishte e aftë të kujdesej për fëmijën.

Ndonëse ky rast ka ndodhur në vitin 2016, pra para ligjit “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, që lidh parimin e “interesit më të lartë

të fëmijës”, gjithashtu me aftësinë e prindit për t’u kujdesur për fëmijën, fakti që nëna “u largua nga qyteti”, pra duke iu larguar mbikëqytjes së Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës, ende ngre pyetje. Në veçanti, pyetjet ngrihen në lidhje me mënyrën se si policia dhe shërbimet sociale punojnë së bashku dhe në lidhje me kapacitetin për të ndjekur në vijimësi raste komplekse me konsideratën e duhur në interesin më të lartë të fëmijës.

Gjithashtu, u identifikuan një rast i martesës së detyruar të një vajze 13 vjeçare dhe një fejesë e detyruar. Rasti i martesës së detyruar me forcë do të përfaqësonte padyshim një rast të trafikimit të fëmijëve. Megjithatë, përsëri, nuk ka prova për ndjekje penale të burrit me të cilin ishte martuar vajza. Rasti i fejesës së detyruar është më i paqartë. Ndërsa detyrimi i një vajze të fejuar me një person është sigurisht dhunim i lirisë së saj për të zgjedhur, nuk është e qartë nëse ka pasur shfrytëzim në atë masë që do të përbente trafikim në këtë rast.

Siç e vumë në dukje më herët, **mjetet e përdorura për të trafikuar fëmijët nuk kanë lidhje me përkufizimin ligjor për veprën e trafikimit të fëmijëve.** Megjithatë, për të kuptuar më mirë realitetet e trafikimit të fëmijëve në Shqipëri, dhe për të ndihmuar në identifikimin sa më të mirë të masave parandaluese dhe atyre mbrojtëse, ky studim është përpjekur të identifikojë nga rastet e shqyrtuara mjetet me anë të të cilave të rriturit kanë trafikuar fëmijët në situata shfrytëzimi.

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC) identifikon tre kategori të vulnerabilitetit: personale, situacionale dhe rrethimore.<sup>10</sup>

Nuk është nevoja të theksohet se trafikantët shfrytëzojnë vulnerabilitetin personal të fëmijëve që ata shfrytëzojnë.<sup>11</sup> Ky vulnerabilitet personal i fëmijëve mund të përkeqësohet më tej nga vulnerabiliteti që lidhet me situatën dhe rrethanat e fëmijës. Për shembull, një fëmijë mund të jetë në një vend të huaj e, për rrjedhojë, i izoluar në aspektin social dhe gjuhësor (vulnerabilitet situacional). Një fëmijë mund të jetë nga një familje e varfër (vulnerabilitet rrethimor).

<sup>10</sup> [https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC\\_2012\\_Guidance\\_Note\\_-\\_Abuse\\_of\\_a\\_Position\\_of\\_Vulnerability\\_E.pdf](https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC_2012_Guidance_Note_-_Abuse_of_a_Position_of_Vulnerability_E.pdf)


<sup>11</sup> Relacioni i Konventës së Këshillit të Evropës për veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore e përshkruan abuzimin e një pozicioni të cenueshëm si “abuzim i çdo situatë në të cilën personi i përfshirë nuk ka asnjë alternativë reale dhe të pranueshme përveç nënshtrimit ndaj abuzimit.

Dobësia mund të jetë e çdo lloji, qoftë fizike, psikologjike, emocionale, në lidhje me familjen, sociale ose ekonomike. Situata, për shembull, mundet të përfshijë pasiguri ose paligjshmëri të statusit administrativ të viktimës, varësi ekonomike ose shëndet të brishtë. Pra, situata mund të jetë një gjendje vështirësie në të cilën një qenie njerëzore detyrohet të pranojë të jetë i shfrytëzuar. Personat që abuzojnë në një situatë të tillë në mënyrë flagrante shkelin të drejtat e njeriut dhe shkelin dinjitetin dhe integritetin njerëzor, të cilën askush nuk mund ta heqë në mënyrë të vlefshme.

## 5.1 Shfrytëzimi i vulnerabilitetit personal: gjinia

Siç u vu në dukje më lart, 31 raste ishin vajza të moshës 13 deri në 16 vjeç, 24 prej të cilave ishin klasifikuar nga autoritetet si viktima të mundshme të trafikimit. Në bazë të dosjes së rasteve, të paktën 26 % e vajzave kishin përjetuar dhunë fizike. Në secilin prej 31 rasteve, ne kemi gjetur elemente të neglizhimit prindëror, abuzim, dhunë, martesë të detyruar dhe të hershme, dhunë nga të dashurit ose trafikantët e mundshëm. Është një fakt i njohur se dhuna e rrit vulnerabilitetin e vajzave dhe grave ndaj trafikimit duke ulur vlerësimin që kanë për veten. Për më tepër, përpjekjet për të lënë mjedise abuzive familjare mund të përkeqësojnë më tej vulnerabilitetin e tyre ndaj trafikimit.

Elemente të kërcënimit, forcës, dhe dhunës ishin më të dukshme në dosjet që kishin të bënin me vajzat e trafikuar për shfrytëzim seksual dhe më pak të dukshme në rastet e djemve të detyruar të lypin. Megjithatë, mungesa e treguesve të qartë të kërcënimit dhe forcës ka gjasë të jetë për shkak të mungesës së hetimeve proaktive më shumë se sa për shkak të mosekzistencës së treguesve. Në të paktën dy raste, djemtë 12 dhe 15 vjeç përkatësisht, i deklaruan punonjësit të mbrojtjes së fëmijës se i kishte rrahur prindi ose kujdestari ligjor për t'i detyruar të lypin.



●	<b>3</b> Raste	Dhuna në familje
●	<b>1</b> Rast	Abuzuar seksualisht nga babai
●	<b>2</b> Raste	Dhunë nga i dashuri
●	<b>2</b> Raste	Martuar me detyrim
●	<b>2</b> Raste	Vajzat përdorin dhunën në familje kundër prindit/kujdestarit

Figura 9: Gjinia si faktor vulnerabiliteti



## RAST STUDIUMI

A është një vajzë 15 vjeçare nga Lezha që ka jetur në kushte shumë të vështira social-ekonomike me familjen. Në vitin 2017, ajo filloi të qëndronte larg shtëpisë për ditë me radhë, në shoqërinë e burrave të panjohur. Ajo e braktisi shkollën, mbeti shtatzënë dhe lindi një foshnjë babai i të cilit nuk njihet. Ajo u rekrutua dhe u punësua në një klub nate ku aludohet se u shfrytëzuar për qëllime prostitucioni. Vajza u intervistua formalisht në prezencën e një Oficeri të Policisë, Shërbimit Social Rajonal dhe një punojësi të mbrojtjes së fëmijës prej nga u identifikua si viktimë e mundshme e trafikimit.

## 5.2 Shfrytëzimi i vulnerabilitetit që lidhet me situatën: varësia ndaj substancave narkotike dhe alkoolit

Në pesë raste të djemve të shfrytëzuar nga anëtarët e një bande për vjedhje dhe shpërndarje droge, ata kishin krijuar varësi ndaj substancave narkotike dhe alkoolit. Ndonëse nuk ka pasur ndonjë hetim për lidhjen e varësisë ndaj alkoolit dhe drogave me trafikimin, ky është një mjet i mundshëm që përdoret nga trafikuesit për të rritur kontrollin e tyre mbi fëmijët.

Instituti i Shëndetit Publik e përfshin alkoolin në substancat depresante, e cila “ngadalëson funksionin e trurit, përfshirë mesazhet nga truri dhe drejt tij”<sup>12</sup>. Prandaj, është e mundur që edhe në disa raste alkooli të përdoret nga fëmijët si një mekanizëm për t’i ndihmuar të përballojnë rrethanat e vështira.

12 (ISHP) “Drogat dhe pasojat e përdorimit të saj tek të rinjtë”, [http://www.ishp.gov.al/multimedia/botime/broshure\\_droga.pdf](http://www.ishp.gov.al/multimedia/botime/broshure_droga.pdf)

Leslie (2011)<sup>13</sup> në studimin e saj mbi prostitucionin dhe kërkesën për shërbime seksuale, ka gjetur se vajzat e trafikuar për shfrytëzim seksual midis moshës 12 dhe 14 vjeç, shpesh kishin varësi ndaj drogave si dhe shfaqnin probleme të tjera mendore. Kjo u has edhe në gjetjet e këtij studimi, i cili gjeti raste të shpeshta të përdorimit të alkoolit nga vajza viktime të mundshme të trafikimit, veçanërisht te rastet e punësuar si balerina në klubet e natës dhe që dyshohej se trafikoheshin për shfrytëzim seksual.

Informacioni i regjistruar në lidhje me këto raste, shpesh nuk bën dallim të qartë midis substancave të përdorura nga fëmijët që janë viktime të mundshme të trafikimit, shkallës së varësisë dhe, më e rëndësishmja, hapave të ndërmarrë për

trajtimin e këtyre fëmijëve.

Trajtimi i varësisë ndaj drogave dhe shëndeti mendor mbetet një sfidë për sistemin e mbrojtjes për shkak të mungesës së shërbimeve të dedikuara dhe mungesës së informacionit për hapat që duhen ndërmarrë në lidhje me rastet.

Protokolli Kombëtar për Trajtimin e Çrregullimeve të Përdorimit të Substancave në Shqipëri (2018) cakton një qendër të specializuar pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me një kapacitet prej 20 shtretërish.

Shërbimet e shëndetit mendor nuk ofrojnë trajtimin e përdorimit të drogës, përveç rasteve kur abuzimi shoqërohet me probleme psikiatrike.<sup>14</sup>



## RAST STUDIMI

*“M” është një vajzë 14 vjeçare nga Tirana, e cila u identifikua në një fshat në jug të Shqipërisë. Ajo jetonte me një djalë më të rritur se vetja, kishte probleme të shëndetit mendor dhe varësi nga alkooli. Pas intervistës fillestare, vajza u identifikua si viktimë e mundshme e trafikimit. Megjithëse ajo paraqiste tregues të fortë trafikimit, përfshirë dyshime për shfrytëzim prostitucioni - punë e fshehtë si balerinë, lëvizje nga Tirana drejt fshatit dhe përdorimi i dhunës nga partneri - ajo nuk u identifikua formalisht si viktimë e trafikimit. Vajza u referua në një strehëz për viktimat e trafikimit, por nuk pranoi të shkonte në qendër dhe u largua nga banesa bashkë me të motrën.*

13 Leslie, B.(2011) The John next door, Vol.158, Issue4

14 Sulaj et al. (2018) Protokolli Kombëtar për Trajtimin e Çrregullimeve të Përdorimit të Substancave në Shqipëri.

## 5.3 Shfrytëzimi i vulnerabilitetit rrethanor: varfëria

Shfrytëzimi i vulnerabilitetit rrethanor u vërejt në këtë studim në veçanti në lidhje me rastet e lypjes së fëmijëve ose të punës për të gjeneruar të ardhura për familjet e tyre shumë të varfra. Në këto raste, rrethanat e fëmijëve mund të përkeqësohen më tej nga mungesa e kujdesit prindëror apo nga forma të dhunës në familje.

Është një fakt i njohur se ka lidhje të forta midis punës së papranueshme të fëmijëve dhe kufizimeve financiare të familjeve, vështirësive sociale. Ky studim tregon se ka, gjithashtu, lidhje të forta midis varfërisë së familjeve dhe trafikimit të fëmijëve.

Lehtësimi i varfërisë për të siguruar standardet e jetesës së familjes dhe të ardhura për ta bërë të panevojshme përfshirjen e fëmijëve në aktivitet ekonomik është një prej rekomandimeve kyçe të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për trajtimin e punës së papranueshme të fëmijëve.<sup>15</sup> Megjithatë, specifikat e rasteve të përshkruara më sipër sugjerojnë se ka një nivel të lartë sfide dhe

kompleksiteti që shoqëron rastet në të cilat fëmijët trafikohen ndërkohë që mbeten në kontekstin e familjes.

Situata social-ekonomike tejet e varfër e familjeve paraqitet nga punonjësit e mbrojtjes së fëmijës si një faktor shtytës në të gjitha rastet e studiuara.

Fakti që fëmijët janë vendosur në rrethana të tilla nga të rriturit që supozohet t'i mbrojnë ata mund të shihet si një tradhti e konsiderueshme e besimit të fëmijëve. Më tej, jeta në rrugë i ekspozon fëmijët ndaj njohjeve me persona të rritur që mund t'i shfrytëzojnë më pas.

Sipas përkufizimit të legjislacionit ndërkombëtar, këto raste përbëjnë format më të këqija të punës së fëmijëve dhe trafikim të mundshëm të fëmijëve. Megjithatë, sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, këto raste mund të kategorizohen nën nenin 124/b “Keqtrajtimi i të miturve”, i dënueshëm me 2 deri në 5 vjet burg.



### RAST STUDI

*E XH, një djalë 15 vjeçar nga Durrësi jeton me babanë me aftësi të kufizuar në kushte tejet të vështira ekonomike. E ëma e braktisi vite më parë dhe ai nuk ka kontaktuar me të asnjëherë.*

*E XH paraqet çrregullime mendore dhe në sjellje. Ai ka qenë në situatë rruge për katër vjet, duke lypur, duke shitur drogë, duke vjedhur dhe me raste ka punuar në lavazhe makinash. Pas vlerësimit të tij, ku u përfshi edhe një vlerësim i shëndetit mendor, ai u vendos në shtëpinë e fëmijëve në Shkodër e më pas në një strehëz në Elbasan, nga ku u arratis. Tani djali jeton në Durrës me të atin dhe rasti i tij monitorohet nga një Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës.*

<sup>15</sup> R146 – ILO Rekomandimi për Moshën Minimale, 1973 (No. 146)

OSBE-ja vë në dukje se përcaktimi i vendndodhjes dhe identifikimi i personave të trafikuar është një problem themelor në të gjitha strategjitë antitrafikim. Për një mori arsyes, ata që kanë ngecur në trafikimin e qenieve njerëzore shpesh nuk duan ta zbulojnë statusin apo përvojat e tyre para autoriteteve shtetërore. Shpesh, viktimat kanë frikën e hakmarrjes së dhunshme nga trafikantët. Për shkak se viktimat e trafikimit janë shpesh ngurrues fillimisht për ta identifikuar veten si të tillë, termi “persona të prezumuar të trafikuar” përdoret përgjithësisht për të përshkruar personat që kanë të ngjarë të jenë viktima të trafikimit dhe që për rrjedhojë renditen në objektivin e përgjithshëm të programeve dhe shërbimeve të antitrafikimit.<sup>17</sup>

Nga rastet e shqyrtuara në këtë studim, 39 ishin të klasifikuara nga autoritetet si viktima të mundshme të trafikimit dhe gjashtë raste nuk ishin klasifikuar me elemente trafikimi. PSV-të për anti-trafikimin i përkufizojnë hapat nga secili institucion për qëllimin e identifikimit fillestar ose formal të një viktime ose një viktime të mundshme të trafikimit, duke krijuar kështu mundësinë për një sistem të efektshëm mbrojtjeje.

Sipas PSV-ve, identifikimi është një proces që përfshin dy hapa:

### “Identifikimi dhe Reagimi Fillestar”:

është një grup veprimesh që duhet të ndërmerren nga institucionet shtetërore dhe joshtetërore për mbrojtjen e personave të trafikuar si jashtë kufinjve edhe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ai ka të bëjë si me agjencitë vendore edhe ato qendrore, dhe parashtron procesin që përcakton se një i mitur apo person në moshë madhore është viktimë potenciale e trafikimit të personave. Instrumentet e identifikimit të hershëm mbështeten në tregues dhe intervista: nëse sjellja dhe pamja e jashtme e personit kanë elemente që përfshihen në listën e treguesve, atëherë personi kalon në intervistën fillestare.

“Identifikimi formal”: është identifikimi i një personi si viktimë e trafikimit, që bëhet vetëm nga Grupi/Struktura Përgjegjëse për Identifikimin Formal (G/SPIF), në bazë të formatit të intervistës formale të përfshirë në këtë dokument. I vetmi mjet për identifikimin formal janë këto intervista formale/zyrtare.

Në lidhje me identifikimin e viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit, në këtë studim, 87 % e rasteve janë identifikuar si **viktima të mundshme të trafikimit**.

Më poshtë do të diskutojmë rreth metodës së identifikimit të rasteve.

16 Titulli i plotë: “Mekanizmi Kombëtar të Referimit për identifikimin, referimin dhe asistencën e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”.

17 OSBE/ODIHR “Mekanizmat Kombëtarë të Referimit. Përpjekjet e Përbashkëta për të Mbrojtur të Drejtat e Personave të Trafikuar”. Manual Praktik, 2005.

Titulli në origjinal: OSCE/ODIHR “National Referral Mechanisms. Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons. A Practical Handbook. 2005.




Figura 10: Përmbledhje e identifikimit

RASTE TE RAPORTUARA NGA:




Figura 11: Burimet e identifikimit

Sic u vu në dukje në tabelën më sipër, 22 nga 45 rastet e menaxhuara u identifikuan nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës, ndjekur nga policia, shkolla dhe familjet. Sipas PSV-ve anti-trafikim, ekipet e përbashkëta të formuara me përfaqësues të policisë dhe Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijës, realizuan intervistat fillestare, duke arritur në përfundimin se 39 rastet ishin viktimë të mundshme të trafikimit.

PSV-të përcaktojnë Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijës si pjesë të grupit përgjegjës për identifikimin formal të viktimave.

Megjithatë, duket se në disa raste ky identifikim realizohet edhe në prezencën e përfaqësuesve të Shërbimit Social Shtetëror. Intervista formale ka një qëllim të vetëm: "... Përcaktimin nëse një

person është i trafikuar, nëpërmjet mbledhjes dhe analizimit të informacionit të dhënë nga vetë personi".

Përveç një rasti në 2016, intervista nuk çoi në identifikimin "formal" të fëmijës si viktimë e trafikimit. Për më tepër, nuk janë aplikuar formatet e PSV-ve anti-trafikim, të cilat janë të detyrueshme për fëmijët viktimë të mundshme të trafikimit.

Pavarësisht faktit se identifikimi i një viktime të trafikimit është një përpjekje komplekse dhe e gjatë, hendeku i madh midis Viktimave të Mundshme dhe Viktimave të Identifikuara të trafikimit të fëmijëve ngre shqetësime në lidhje me efektshmërinë e angazhimit të strukturave përkatëse dhe përpjekjeve proaktive për zbatimin e ligjit. Udhëzuesi i OSBE-së për Mekanizmin



Kombëtar të Referimit thekson se “një person i trafikuar mund të identifikohet në mënyrë përfundimtare si i tillë nëse zbulohen elementet e dallueshme të krimit të trafikimit. Kjo mund të kërkojë kohë për shkak të kompleksitetit të krimit të trafikimit dhe statusit të cenueshëm të personave të trafikuar që vuajnë nga çrregullimi i stresit post-traumatik”.

OSBE-ja thekson se në kontekstin e trafikimit të qenieve njerëzore, mbrojtja i referohet proceseve të mbrojtjes së të rriturve ose fëmijëve nga dëmtimi i mëtejshëm (duke nisur nga shkaputja nga duart e trafikantëve), duke u dhënë atyre ndihmesën e duhur për ta rimarrë veten nga çdo lloj dëmi që mund të kenë pësuar dhe të rinisin jetën, si dhe të kenë qasje në zgjidhje të përshtatshme, ose nëpërmjet gjykatave ose nëpërmjet rrugëve të tjera.<sup>18</sup>

Qasja e të drejtave të fëmijës është parimi gjithëpërfshirës në legjislacionin shqiptar për të drejtat e fëmijës, i cili thekson se interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.<sup>19</sup>

Në lidhje me rastet e shqyrtuara në këtë studim, ne kemi marrë në konsideratë përprojekjet e ndërmarra për interesin më të lartë të fëmijëve nga strukturat dhe sistemet ekzistuese. Studimi analizon nëse proceset kanë siguruar qasjen për interesin më të lartë të fëmijës duke dhënë zgjidhje të menjëhershme dhe të qëndrueshme në kohë për fëmijët në rrezik dhe viktimat e trafikimit.

Për shkak të informacionit të kufizuar në dispozicion, është e vështirë nxjerrja e përfundimeve në lidhje me efektshmërinë e masave për mbrojtjen e fëmijës.

Megjithatë, kjo mungesë informacioni jep sugjerime të forta për një mungesë bashkërendimi midis institucioneve për të mundësuar një mjedis mbrojtës për fëmijët në rrezik dhe viktimat e trafikimit.

## 7.1 Mbrojtja e menjëhershme


Vlerësimi i rrezikut, i cili është pika e nisjes së procedurave për menaxhimin e rastit shtjellohet me hollësi në legjislacionin shqiptar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës<sup>20</sup>. Sa i takon kontekstin të veçantë të trafikimit të fëmijëve, vlerësimi i rrezikut përfshin një **vlerësim të sigurisë si dhe vlerësim të nevojave** të fëmijës dhe familjes. Sipas nivelit të rrezikut, vlerësimi i sigurisë dhe i nevojave përcaktojnë vendimin që do të merret për fëmijën nga një grup me përfaqësues nga disa sektorë. Vendimi duhet të marrë në konsideratë sigurinë e fëmijës dhe interesin më të lartë për t'u kthyer ose jo në familje, nëse fëmijës i duhet dhënë kujdes alternativ, apo nëse duhet të ndiqet me mbështetje edukimi dhe sociale pranë familjes.

18 OSCE Office of the Special Representative and Co-ordinator for Combating Trafficking in Human Beings. "Child Trafficking and Child Protection: Ensuring that Child Protection Mechanisms Protect the Rights and Meet the Needs of Child Victims of Human Trafficking", f 18.

19 Ligji Nr 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës". Neni 5: Parime të përgjithshme.

20 Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr 578, datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes".

Procedurat e menaxhimit të rastit<sup>21</sup> parashikojnë llojet e rrezikut si më poshtë:



### **Rrezik shumë i lartë (emergjent)**

*Situata në të cilën gjendet fëmija, i cili, në momentin e identifikimit nuk ka aftësi vetëmbrojtëse dhe, nëse lihet në rrethanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse apo kujdes shëndetësor, mund të vdesë, të dëmtohet ose të plagoset rëndë, mund të abuzohet seksualisht, të trafikohet apo të jetë pre e keqtrajtimit të tjera, të konsideruara vepër penale, sipas Kodit Penal.*

*Ndërhyrja, në këtë rast, duhet të jetë urgjente dhe të sigurojë largimin e fëmijës nga situata e rrezikut.*



### **Rrezik i lartë**

*Situata në të cilën gjendet fëmija rrezikon që të dëmtohet rëndë, të jetë subjekt i llojeve të ndryshme të abuzimit në mënyrë të vazhdueshme apo të dëmtohet në mënyrë të tillë që të vuajë nga paaftësi të përhershme ose t'i rrezikohet seriozisht mirëqenia, nëse nuk merren masa për ta mbrojtur.*



### **Rrezik i mesëm**

*Situata në të cilën gjendet fëmija, për të cilin nuk ka të dhëna që të jetë në rrezik për të pësuar dëmtime të rënda apo të ketë pësuar dëmtime të rënda, por ekziston mundësia që të dëmtohet apo të abuzohet, nëse nuk merren masa për ta mbrojtur. Ndërhyrja për të mbrojtur fëmijën dhe për të ofruar shërbime është e domosdoshme.*



### **Rrezik i ulët**

*Një situatë në të cilën fëmija është relativisht i sigurt, nuk vuan nga dëme si rrjedhojë e abuzimit dhe është në gjendje ta mbrojë veten. Megjithatë, mbeten të pranishëm faktorë rreziku dhe fëmija mund të bjerë pre e abuzimit, dhunës, neglizhencës ose shfrytëzimit, nëse nuk merren masa për të ofruar respektim të të drejtave dhe qasje në to ose nëse nuk jepen shërbime.*

<sup>21</sup> Po aty.

Në bazë të përkufizimit të niveleve të rrezikut, 29 fëmijë u konsideruan në “rrezik të lartë” dhe 15 në “rrezik të menjëhershëm”.<sup>22</sup>

**për fëmijën dhe familjen.** Dukshëm, 8 nga 11 rastet janë vajza të shfrytëzuara seksualisht, pra ende në duart e trafikuesve të tyre.



Figura 12: Klasifikimi i rasteve sipas faktorit të rrezikut

**Duhet theksuar si fakt që në 41 nga 45 raste gjithsej, u mblodh grupi teknik ndërsektorial, sipas parashikimit ligjor në Vendimin e Këshillit të Ministrave për procedurat e menaxhimit të rastit.**<sup>23</sup>

Duke marrë në konsideratë parimin e interesit më të lartë të fëmijës sipas së cilës fëmija duhet të largohet menjëherë nga situata e shfrytëzimit, ne vumë re se **në 11 raste shfrytëzimi vijoi edhe në fazën e post-identifikimit, pavarësisht përpjekjeve të PMF-së për të siguruar asistencë**

Në këtë kontekst, paragjykimi negativ bazuar në përkatësinë gjinore, mund të ketë ndikuar në efektshmërinë e përpjekjeve hetimore, duke çuar në vazhdimin e shfrytëzimit. Kjo neglizhencë në veçanti kërkon një analizë më të thellë, çka nuk është objekti i këtij studimi. Në një rast, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës u shpreh se ishte kërcënuar nga persona të dyshuar si trafikantët e vajzës. Me sa duket, një vlerësim i dobët i rrezikut çoi në vijimin e shfrytëzimit.

### LARGIMI I MENJËHERSHËM NGA SITUATAT E DËMSHME DHE SHFRYTËZUESE




Figura 13: Dështimet në mbrojtjen e fëmijës

<sup>22</sup> Një rast u menaxhua para hyrjes në fuqi të legjislacionit të ri për mbrojtjen e fëmijës.

<sup>23</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, neni 8.

## 7.2 Masat e mbrojtjes

Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës (PMF) përballen me vendime serioze në fazën fillestare të identifikimit si dhe gjatë vlerësimit të plotë të situatës së fëmijës. Në bazë të vlerësimit fillestar dhe atij të plotë, PMF-ja është menaxheri i rastit i cili duhet të sigurojë që fëmijës në rrezik për të qenë viktimë e trafikimit t'i jepet mbrojtje emergjente dhe mbështetje afatgjatë, në bazë të një Plani Individual Mbrojtjeje.

Masat e mbrojtjes të parashikuara në procedurat e menaxhimit të rastit<sup>24</sup> përfshijnë:

**Mbrojtja emergjente** - fëmija është në rrezik të lartë dhe të menjëhershëm për shkak të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit, është braktisur në lindje apo është në moshën 16 vjeç; nuk ka kontroll prindëror.

**Vendosja e fëmijës në përkujdesje alternative** – nuk mund të jetë nën kujdesin e ndonjë të afërmi; është interesin më të lartë të fëmijës; është zgjidhja e fundit.


**Mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar** – mund të trajtohet në mjedisin familjar.

Situata e masës së mbrojtjes për rastet e analizuara paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Siç e vumë në dukje në grafik, pjesa më e madhe e rasteve, 31 nga 45 prej tyre, nuk janë trajtuar me një masë mbrojtjeje, duke ngritur shqetësime për efikasitetin e masave të mbrojtjes të zbatuara për të siguruar përkujdes bazë, strehim të sigurt dhe, më e rëndësishmja, mbrojtje nga trafikantët dhe abuzuesit.

Megjithëse studimi nuk fokusohet te cilësia e të gjitha përpjekjeve të ndërmarra nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës në mënyrë të drejtpërdrejtë si dhe nëpërmjet grupeve ndërsektoriale, disa raste tregojnë se janë ndërmarrë procedura jo tradicionale dhe të pa rekomanduara, të cilat nuk nxisin interesin më të lartë të fëmijës.

Për shembull, një nënë me probleme të shëndetit mendor u kap në përpjekje për të trafikuar foshnjën e saj njëvjeçare në Greqi për qëllime birësimi. Pas identifikimit, foshnja iu rikthye të ëmës. Paketa e asistencës përfshinte ushqim dhe ndihmë mjekësore. Grupi teknik ndërsektorial vendosi mbikëqyrje policore për nënën, e cila ndryshoi vendndodhjen dhe humbi gjurmët.



### MASAT E MBROJTJES

- Masë mbrojtjeje emergjente
- Masë mbrojtjeje vendosje në institucion rezident
- Masë mbrojtjeje ndjekje në familje
- Pa masë mbrojtjeje

Figura 14: Përmbledhie e masave të mbrojtjes

<sup>24</sup> Po aty, nenet 18-20.

Në të gjitha rastet e vajzave që kryenin “punë të fshehura” dhe dyshoheshin se trafikoheshin/ose shfrytëzoheshin seksualisht, është e pamundur të evidentohet situata e trafikimit dhe asistenca e dhënë, për shkak të mungesës së një vlerësimi të plotë të rrezikut dhe të nevojave.

Përfitimi nga shërbimet është një tjetër shqetësim

madhor. Së pari, mungesa e qendrave rezidenciale për djem të identifikuar si viktime të mundshme të trafikimit, në veçanti ata mbi moshën 14 vjeç që shfaqin varësi ndaj substancave narkotike dhe alkoolit. Ata janë një grup i vështirë për personelin e strehëzave, duke qenë se kërkojnë shërbime të specializuara dhe përshtatje të vazhdueshme të Planit Individual të Mbrojtjes.

Shqyrtimi i rasteve, përfshirë marrjen në konsideratë të informacionit të disponueshëm dhe mënyrën në të cilën janë trajtuar fëmijët e përfshirë nga ata që janë përgjegjës për mbrojtjen e tyre, çon në një numër përfundimesh.

Një pjesë e mirë e legjislacionit dhe politikave përkatëse në Shqipëri përbëjnë një bazë të fortë për një reagim të efektshëm ndaj trafikimit të fëmijëve, brenda një kuadri të gjerë për mbrojtjen e fëmijës. Megjithatë, të dhënat e shqyrtuara në këtë studim sugjerojnë se potenciali i plotë i këtij kuadri nuk po realizohet, për shkak të zbatimit të pakënaqshëm nga aktorët kyç përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës. Kjo është problematike sepse të dhënat e shqyrtuara tregojnë se ka një prezencë domethënëse të trafikimit të fëmijëve si brenda edhe jashtë kufijve të Shqipërisë.

Puna në klube nate çon në rreziqe të konsiderueshme trafikimi për shfrytëzimin seksual të vajzave.

Me gjithë treguesit e fortë për trafikimin e fëmijëve dhe intervistat formale, u vërejt një prirje për të shmangur klasifikimin si viktimë e trafikimit duke pasur parasysh faktin se u identifikua formalisht vetëm një nga 39 rastet e trafikimit të mundshëm.

Një shqetësim tjetër serioz është se për 11 rastet e identifikuara si viktimë të mundshme të trafikimit, tetë prej tyre femra viktimë të mundshme për shfrytëzim seksual të fëmijëve, kishin pasur tregues që sugjeronin shfrytëzim të vazhdueshëm pas këtij identifikimi.

Intervistat formale për identifikimin e trafikimit nuk duket se realizohen sipas formateve të miratuara, të cilat mund të tregojnë se punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës në përgjithësi nuk i njohin proceset dhe procedurat anti-trafikim.

Ky studim gjeti se të dhënat janë shpesh të papajtueshme dhe se ende nuk ishte krijuar një bazë të dhënash e unifikuar për mbrojtjen e fëmijës. Mungesa e tyre paraqet një kufizim të konsiderueshëm për ngritjen e sistemeve të efektshme për mbrojtjen e fëmijës.

Në përgjithësi, Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës nuk kanë informacion mbi hetimin e trafikantëve të dyshuar. U identifikua vetëm një rast i regjistrimit të hetimit penal pas përcaktimit të fëmijës së viktimë e mundshme e trafikimit.

Ka të dhëna se shpesh Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës, të cilët sipas ligjit janë përgjegjës për të gjitha aspektet e menaxhimit të rastit, humbasin kontaktin me rastet pas referimit të tyre në strehëza ose në shërbime të tjera sociale. Për këtë arsye, fluksi i informacionit midis strehëzave dhe PMF-ve duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i formalizuar.

- Fëmijët që janë detyruar të kryejnë veprimtari kriminale trajtohen si autorë të veprave penale dhe jo si viktime të trafikimit dhe të abuzimit.
- Paragjykimet gjinore me gjasë ndikojnë në mungesën se hetimeve proaktive, në veçanti në rastet e trafikimit të vajzave për shfrytëzim seksual.

Nuk ka shërbime të dedikuara për fëmijët që vuajnë nga varësia ndaj substancave narkotike dhe alkoolit. Për reagimin ndaj këtyre çështjeve, jepen rekomandimet e mëposhtme:



## Trajnimi

- Forcimi i njohurive dhe kapaciteteve të Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijës në lidhje me treguesit dhe proceset e trafikimit të fëmijëve.
- Inkurajimi i seminareve të përbashkëta trajnimi mes policisë, mbrojtjes së fëmijës dhe strukturave sociale për çështje që kanë të bëjnë me trafikimin e fëmijëve dhe punën e fëmijëve.
- Zgjerimi i trajnimit për të përfshirë policinë kufitare, oficerët e policimit në komunitet, prokurorët dhe gjyqtarët.
- Rritja e ndërgjegjësimit të strukturave ligjzbatuese për statusin e viktimës për fëmijët e shfrytëzuar për veprimtari kriminale, përfshirë zbatimin e së drejtës së “përrjashtimit nga dënimi”.
- Sesione ndërgjegjësimi në shkolla për rrezikun e trafikimit.



## Sistemi i mbrojtjes së fëmijës

- Forcimi i planeve të monitorimit për fëmijët e vendosur në përkujdesje alternative.
- Forcimi i bashkëpunimit midis policisë, inspektorëve të punës dhe punonjësve të mbrojtjes së fëmijës për të zbuluar, referuar dhe hetuar punën e fëmijëve.
- Përmirësimi dhe unifikimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë, grupmoshës, llojit të shfrytëzimit, llojit të aktivitetit ekonomik, frekuentimit të shkollës dhe vendndodhjes gjeografike.
- Ngritja e programeve specifike për riintegrimin e fëmijëve viktime të trafikimit që vuajnë nga sëmundje mendore dhe varësi ndaj substancave/alkoolit.





## Puna kërkimore në të ardhmen

Ndonëse është e qartë nga analiza se fëmijët detyrohen të kryejnë krime të ndryshme, të tilla si vjedhje të shtëpive, vjedhje të personit, vjedhje të dyqaneve, shpërndarje droge, mbetet e paqartë nga informacioni i disponueshëm se cilat janë mjetet kryesore të përdorura nga trafikuesit për të ushtruar bindjen dhe për të manipuluar fëmijët, profili i trafikantëve dhe se si ata i shënjestrojnë këta fëmijë.

Për këtë arsye, hulumtimi i mëtejshëm në llojet e abuzimit me fëmijët dhe dhunën ndaj tyre në Shqipëri që çojnë në trafikimin e fëmijëve mund të ndihmojë për të kuptuar më qartë masat e nevojshme për identifikimin dhe mbrojtjen.

Po ashtu, edhe studimi i faktorëve që i çojnë vajzat drejt braktisjes së familjeve mund të ndihmojë për të kuptuar më qartë strategjitë e nevojshme për mbrojtjen e këtij grupi të veçantë vulnerabël ndaj trafikimit.

Studimi i efektit të dyfishtë gjinor në trafikimin e fëmijëve, analizimi i gjinisë si një faktor vulnerabiliteti dhe si një paragjykim që çon në neglizhim për hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit të fëmijëve, sidomos në rastin e vajzave të reja të trafikuar për shfrytëzim seksual.